

1 E enjte, 6 prill 2023

2 [Urdhër për Zhdëmtim]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 12.00

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëdita dhe mirë se erdhët.

8 Z. Sekretar i Seancës, ju lutem, a mund të thërrisni  
9 çështjen.

10 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
11 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
12 Specializuar kundër Salih Mustafës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, z. Sekretar.

15 Së pari, dua që palët të prezantohen.

16 Mbrojtja e Viktimave, fjala për ju.

17 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

18 Mirëdita të gjithëve. Mbrojtja e Viktimave sot përfaqësohet  
19 nga unë, Anni Pues dhe znj. Vossenberq.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Avokati i Mbrojtjes, fjala për ju.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

24 Unë jam përfaqësuesi i të akuzuarit, z. Von Bone. Dhe kemi  
25 gjithashtu z. Mustafa të pranishëm në seancë sot.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra  
2 e Prokurorit të Specializuar, fjala për juve.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.  
4 Përshëndetje të gjithëve brenda sallës së Gjykatës dhe jashtë.

5 Zyra e Prokurorit të Specializuar është e përfaqësuar sot  
6 nga z. Alex Whiting, ushtrues i detyrës si Prokuror i  
7 Specializuar; Julie Mann, menaxhere e çështjes; dhe unë jam  
8 Prokurore, Silvia D'Ascoli.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra  
10 Administrative, z. Roche.

11 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Unë  
12 jam Ralph Roche, jam drejtues i Seksionit të Çështjeve  
13 Ligjore.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi  
15 Gjykses numër I do të nxjerrë sot Vendimin për Zhdëmtim në  
16 çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Sali  
17 Mustafës. Ky urdhër për zhdëmtim shqiptohet publikisht dhe në  
18 praninë e z. Mustafa. Ndonëse do të lexoj përmbledhjen e  
19 konstatimeve kryesore të Trupit Gjykses, kjo përmbledhje nuk  
20 është pjesë e Urdhrit për Zhdëmtim, i cili është i vetmi  
21 version autoritativ i vendimit dhe konstatimeve të Trupit  
22 Gjykses, përmbledhja që nuk është version autoritativ do të  
23 jetë i disponueshëm në faqen e internetit të DHSK-së.

24 Fillimisht, dua të theksoj se seanca e sotme shënon edhe  
25 një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara të

1 Kosovës meqenëse lëshohet urdhri i parë për zhdëmtim i kësaj  
2 Gjykate. Zhdëmtimi është pjesë themelore e proceseve gjyqësore  
3 në DHSK. Ai është themelor për realizimin e drejtësisë për  
4 viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të  
5 së drejtës humanitare ndërkombëtare.

6 Ky Urdhër për Zhdëmtim buron nga shpallja e fajësisë  
7 kundër z. Salih Mustafa, datë 16 dhjetor 2022. Në këtë  
8 kontekst, rikujtoj se ky Trup Gjykues shpalli z. Mustafa  
9 fajtor lidhur me tre akuza për krime të rënda, përkatësisht  
10 për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme, të  
11 cilat ai i kreu drejtpërdrejt dhe si pjesë e një ndërmarrje  
12 kriminale të përbashkët afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe  
13 fundit të prillit 1999, në një kompleks në Zllash në Kosovë.  
14 Z. Mustafa u dënua me 26 vjet burgim, brenda të cilit i  
15 llogaritet koha e kaluar në objektin e paraburgimit në DHSK që  
16 nga 24 shtator 2020.

17 Rikujtoj se viktimat pjesëmarrëse në këtë proces ishin  
18 nën masa mbrojtëse; përkatësisht që emrat dhe të dhënat e tyre  
19 identifikuese nuk janë bërë të ditura publikut. Në përputhje  
20 me këtë, gjatë kësaj seance, viktimave duhet t'i referohemi me  
21 kode që iu janë caktuar. Trupi Gjykues gjithashtu ka shqyrtuar  
22 me kujdes se çfarë informacioni tjetër mund të nxirret  
23 publikisht duke ruajtur ekuilibrin midis nevojës për të  
24 mbrojtur viktimat dhe parimit e procesit publik.

25 Tani do të filloj me përmbledhjen e Urdhrit të

1 Zhdëmtimit.

2 Do të jap një histori procedurale.

3 Më 4 shkurt 2022, Trupi Gjykses I gjykoi se, në rast të  
4 një vendimi fajësie, nuk do t'i udhëzonte viktimat të ngrinin  
5 padi civile në gjykatat e Kosovës, por do të nxirrte një  
6 urdhër për zhdëmtim. Procesi në lidhje me zhdëmtimin, për  
7 rrjedhojë, u zhvillua paralelisht me gjykimin.

8 Më 30 qershor, Mbrojtja e Viktimave dorëzoi një kërkesë  
9 për zhdëmtim në emër të tetë viktimave të pranuar si viktima  
10 pjesëmarrëse në proces.

11 Për një pasqyrë të plotë të dispozitave ligjore dhe  
12 parimeve të zbatueshme i referohem versionit publik për  
13 urdhrin për Zhdëmtim. Në kuadër të kësaj përmbledhjeje  
14 dëshiroj të nënvijëzojë si më poshtë.

15 Trupi Gjykses thekson se zhdëmtimi në Dhomat e  
16 Specializuara të Kosovës ka për qëllim jo vetëm ndëshkimin e  
17 personit të shpallur fajtor sikurse parashikohet në nenin  
18 44(6) të ligjit, por edhe njohjen dhe zhdëmtimin, për aq sa  
19 është e mundur, të dëmit që ju është shkaktuar viktimave.

20 Në përputhej me këtë, viktimat duhet të marrin  
21 dëmshpërblim të arsyeshëm të përshtatshëm dhe të shpejtë.

22 Sa u përket parimeve të zbatueshme për përgjegjësinë e  
23 personit të shpallur fajtor në lidhje me zhdëmtimin, Trupi  
24 Gjykses gjykoi se urdhri për Zhdëmtim nuk mund të dalë jashtë  
25 kuadrit të veprimeve penale për të cilat personi është

1 shpallur fajtor dhe duhet të lëshohet në të gjitha rrethanat  
2 kundër personit të shpallur fajtor. Përgjegjësia e personave,  
3 apo organizatave të tjera ose përgjegjësia e shtetit nuk është  
4 relevante në përcaktimin e përgjegjësisë së personit të  
5 shpallur fajtor lidhur me zhdëmtimin. Po kështu, mungesa e  
6 mjeteve financiare të personit të shpallur fajtor nuk është  
7 relevante në marrjen e këtij vendimi.

8 Shkurtimisht, do të trajtoj tani metodologjinë që përdori  
9 Trupi Gjykses në vlerësimin e provave që paraqitën viktimat  
10 lidhur me zhdëmtimin.

11 Para së gjithash, Trupi Gjykses u mbështet në konstatimet  
12 faktike dhe ligjore të bëra në aktgjykimin e Trupit Gjykses të  
13 cilat çuan në shpalljen e fajësisë dhe dënimin e z. Mustafa.  
14 Trupi Gjykses gjithashtu, shqyrtoi ndër të tjera kërkesën e  
15 Mbrojtjes së Viktimave për zhdëmtim, deklaratën për pasojat,  
16 ekspertizat e IMMO-s dhe raportin Lerz.

17 Së fundi, Trupi Gjykses vuri re se gjatë gjithë procesit  
18 gjyqësor Mbrojtja mbajti të njëjtin qëndrim përkatësisht se;  
19 për shkak të mohimit prej z. Mustafa të çfarëdolloj  
20 përgjegjësie për krimet e paraqitura në aktakuzë, ai nuk është  
21 i detyruar t'i dëmshpërblejë viktimat. Rrjedhimisht, Mbrojtja  
22 nuk paraqiti parashtime materiale në kontekstin e procesit të  
23 zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore.

24 Përpara se të kaloj tek Urdhri për Zhdëmtim kundër z.  
25 Mustafa, do të bëj një përmbledhje të konstatimeve të Trupit

1 Gjykues në lidhje me shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan  
2 viktimat pjesëmarrëse në këtë proces në përputhje me nenin  
3 22(7) të ligjit.

4 Do të filloj me parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave.

5 Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi një kërkesë për zhdëmtim  
6 në emër të tetë viktimave pjesëmarrëse. Mbrojtësja e Viktimave  
7 argumentoi se Viktima 08, Viktima 09 dhe Viktima 10 - më  
8 poshtë do t'i quaj Viktimat e Drejtpërdrejta - pësuan dëm  
9 fizik, mendor dhe material si pasojë e krimeve të luftës të  
10 ndalimit arbitrar dhe torturës të kryera kundër tyre nga z.  
11 Mustafa.

12 Ajo gjithashtu argumentoi se Viktima 05, 06, 11, 12 dhe  
13 13 - më poshtë Viktimat jo të Drejtpërdrejta - pësuan dëm  
14 mendor afatgjatë si pasojë e krimeve të luftës të arrestimit  
15 arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme të kryera nga z.  
16 Mustafa kundër anëtarëve të familjes së tyre me të cilin ata  
17 kishin një lidhje të ngushtë.

18 Tani do të kaloj tek konstatimet e Trupit Gjykues. Do të  
19 jap një përmbledhje të shkurtër të konstatimeve për secilën  
20 prej viktimave. Do të filloj me Viktimat e Drejtpërdrejta.

21 Së pari, Trupi Gjykues u mbështet në konstatimet e bëra  
22 në aktgjykimin e Trupit Gjykues se Viktima 08, 09 dhe 10 u  
23 ndaluan arbitrarisht dhe u torturuan në kompleksin e ndalimit  
24 në Zllash nga z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA dhe pësuan  
25 dëm fizik dhe mendor si pasojë.

1 Sa i takon dëmit fizik që pësoi Viktima 09, Trupi Gjykses  
2 gjykoi se viktima u keqtrajtua pothuajse çdo ditë gjatë kohës  
3 që u mbajt i ndaluar. Ai u mbajt në kushte çnjerëzore dhe  
4 poshtëruese. Për pasojë, atij iu shkaktuan lëndime të shumta  
5 edhe sot e kësaj dite ai vuan fizikisht.

6 Sa i takon dëmit mendor, Trupi Gjykses gjykoi se gjatë  
7 kohës që u mbajt i ndaluar në Zllash, Viktima 09 mundi të  
8 dëgjonte të ndaluarit e tjerë kur keqtrajtoheshin dhe pa  
9 lëndimet që ju ishin shkaktuar kur i kthyen në ahur, ishin të  
10 mavijosur, të përgjakur dhe pavetëdije. Ai jetonte me frikën e  
11 vazhdueshme se mund t'i vinte radha për t'u keqtrajtuar, kjo i  
12 shkaktoi ngarkesë të jashtëzakonshme psikologjike. Viktima 09  
13 gjithashtu ka simptoma të çrregullimit të stresit post-  
14 traumatik.

15 Krahas kësaj, në lidhje me dëmin mendor, Trupi Gjykses  
16 vërejtti se menjëherë pas krimeve, Viktima 09 nuk ishte në  
17 gjendje të bisedonte për ndalimin e tij me asnjërin nga  
18 viktimat e tjera meqenëse ata refuzuan të bisedonin me të për  
19 shkak se, sipas tij, kishin frikë. Ai nuk ishte në gjendje që  
20 të tregonte as mjekut shkakun e vërtetë të lëndimeve që  
21 kishte.

22 Trupi Gjykses konstatoi se kjo ishte pasojë e  
23 stigmatizimit shoqëror që kishte filluar në Zllash kur z.  
24 Mustafa, si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët dhe  
25 anëtarë të tjerë të BIA-s, i etiketuan të ndaluarit në

1 kompleksin e Zllashit si bashkëpunëtorë dhe tradhtarë, ndër të  
2 tjera dhe Viktimën 09, çka e veçoi atë nga komuniteti i tij.  
3 Duke vepruar kështu, z. Mustafa kontribuoi për krijimin e  
4 ndjenjës së izolimit dhe stigmatizimit shoqëror të Viktimës  
5 09. Nga ana tjetër Viktima 09 nuk ju dha mundësi për të  
6 përpunuar traumën.

7 Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se në lidhje me dëmin  
8 material, Viktima 09 pësoi humbje të ardhurash dhe dëmtim të  
9 planeve për jetën meqenëse ju privua për të pasur një karrierë  
10 normale.

11 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se Viktima 09  
12 përjetoi dëm fizik dhe material me pasoja afatgjata, si dhe  
13 dëm material si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit  
14 arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

15 Tani do të kaloj tek Viktima 08.

16 Sa i përket dëmit fizik, keqtrajtimi që iu shkaktua  
17 Viktimës 08 e la atë me dhimbje dhe të mavijosur. Sa i përket  
18 dëmit mendor, Viktima 08 ishte dëshmitar i keqtrajtimit brutal  
19 të të ndaluarve të tjerë dhe vazhdon të ketë frikë edhe sot e  
20 kësaj dite. Viktima 08 shfaq simptoma të çrregullimit të  
21 stresit post-traumatik. Viktima 08 gjithashtu ka përjetuar  
22 pasoja negative të marrëdhënieve personale dhe jetës  
23 familjare. Për këtë arsye ai gjithashtu ka pësuar dëmtim të  
24 planeve për jetën në kuadër të dëmit mendor. Krahas kësaj me  
25 etiketimin e Viktimës 08 si bashkëpunëtor, z. Mustafa, si



1 pjesë e një ndërmarrje kriminale të përbashkët së bashku me  
2 anëtarët e tjerë të BIA-s, e veçoi atë nga komuniteti i tij.  
3 Dhe në këtë mënyrë, z. Mustafa kontribuoi në krijimin e  
4 ndjenjës së frikës tek Viktima 08 për të folur për çfarë i  
5 kishte ndodhur në Zllash apo për të kërkuar fajtorët për atë  
6 ngjarje. Viktimës 08 gjithashtu nuk ju dha asnjë hapësirë për  
7 të përpunuar traumën që ju shkaktua nga koha e kaluar në  
8 Zllash.

9 Sa i përket dëmit material, trauma e fortë mendore që  
10 përjetoi Viktima 08 ndikoi në mundësinë e tij për të zhvilluar  
11 karrierën. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se Viktima  
12 08 pësoi humbje të ardhurash dhe dëmtim të planeve për jetën.

13 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se Viktima 08  
14 përjetoi dëm fizik pa pasoja afatgjatë, dëm mendor me pasoja  
15 afatgjatë, dëm material, si rezultat i krimeve të luftës së  
16 ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Mustafa u  
17 shpall fajtor.

18 Tani kaloj tek Viktima 8 [sipas përkthimit].

19 Sa i takon dëmit fizik, Viktima 10 u keqtrajtua pothuajse  
20 çdo ditë dhe u mbajt në kushte poshtëruese dhe çnjerëzore. Për  
21 pasojë, atij iu shkaktuan lëndime nga të cilat ende nuk është  
22 rimëkëmbur.

23 Sa i takon dëmit mendor, viktima 10 u tmerrua nga zërat e  
24 të tjerëve që bërtisnin dhe rriheshin si dhe nga frika e  
25 vazhdueshme se dhe atij mund t'i vinte radha për t'u

1 keqtrajtuar. Viktima 10 vazhdon të vuajë edhe sot e kësaj  
2 dite.

3 Trupi Gjykses në kuadër të dëmit mendor gjithashtu  
4 vlerësoi se përmes etiketimit të Viktimës 10 si bashkëpunëtor  
5 gjatë kohës së mbajtjes së tij në Zllash, z. Mustafa, si pjesë  
6 e një ndërmarrje kriminale të përbashkët së bashku me anëtarë  
7 të tjerë të BIA-s, veçoi Viktimën 10 nga komuniteti i tij. Në  
8 këtë mënyrë, z. Mustafa kontribuoi në pamundësinë e Viktimës  
9 10 për të kërkuar haptas ndihmë për shërimin e traumës që ju  
10 shkaktua nga koha e mbajtjes së tij në ndalimin në Zllash.

11 Në lidhje me dëmin material, Trupi Gjykses gjykoi se si  
12 rezultat i torturës së përjetuar në Zllash, viktima 10 pësoi  
13 humbje të të ardhurave dhe dëmtim të planeve për jetën.

14 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se Viktima 10  
15 përjetoi dëm fizik dhe mendor me pasoja afatgjata si dhe dëm  
16 material si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar  
17 dhe të torturës për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

18 Tani do të jap një përmbledhje të shkallës dhe përmasave  
19 të dëmit të pësuar nga Viktimat jo të Drejtpërdrejta.

20 Së pari, Trupi Gjykses u mbështet në konstatimet e bëra  
21 në aktgjykimin e Trupit Gjykses në lidhje me ndalimin  
22 arbitrar, torturën dhe vrasjen e paligjshme të një të ndaluarit  
23 në kompleksin e ndalimit në Zllash, për të cilat z. Mustafa u  
24 shpall fajtor. Këtij të ndaluarit do t'i referohemi me "viktima  
25 e vrasjes së paligjshme".

1 Trupi Gjykses vlerësoi se arrestimi i ndalimit arbitrar  
2 dhe më pas vrasjes së paligjshme e viktimës së vrasjes së  
3 paligjshme si dhe rrethanat e tyre, patën pasoja  
4 shkatërrimtare mbi Viktimat jo të Drejtpërdrejta. Ata  
5 përjetuan pikëllim, dhimbje shpirtërore dhe tmerr. Për më  
6 tepër, ata nuk kanë qenë në gjendje të kalojnë pikëllimin për  
7 humbjen e të afërmit të tyre. Kjo u ka bërë atyre më të  
8 vështirë për të vazhduar me jetën e tyre.

9 Trupi Gjykses gjithashtu gjykon se dhimbja dhe vuajtja që  
10 përjetuan anëtarët e familjes së viktimës së vrasjes së  
11 paligjshme ka ndikuar dhe në gjeneratën më të re të kësaj  
12 familjeje.

13 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se Viktimat jo të  
14 Drejtpërdrejta përjetuan dëm mendor si pasojë e krimeve të  
15 luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së  
16 paligjshme, për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor në lidhje  
17 me viktimën e vrasjes së paligjshme.

18 Këtu përfundojnë konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje  
19 me shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat.

20 Dhe tani do të kaloj tek Urdhri për Zhdëmtim kundër z.  
21 Mustafa.

22 Urdhri për Zhdëmtim jepet drejtpërdrejt kundër z.  
23 Mustafa. Përfituesit e zhdëmtimit janë tri viktimat e  
24 drejtpërdrejta dhe pesë viktimat jo të drejtpërdrejta të  
25 përmendura më herët.

1 Në lidhje me llojet dhe modalitetet e zhdëmtimit Trupi  
2 Gjykues vendosi si vijon.

3 Në marrjen e vendimit, Trupi Gjykues mbajti parasysh  
4 faktin që shpallja e fajësisë dhe dënimi i shqiptuar në  
5 aktgjykimin e Trupit Gjykues përbën një lloj mjetei juridik në  
6 formën e njohjes për viktimat. Kjo gjithashtu ju dha viktimave  
7 mundësinë për të kërkuar dhe marrë drejtësi për krimet kundër  
8 tyre ose një anëtarin të familjes së tyre që u kryen më shumë  
9 se dy dekada më parë. Së fundi, kjo kontribuoi në të drejtën e  
10 viktimave të familjeve të tyre dhe të komunitetit të tyre për  
11 të pasur qasje në të vërtetën.

12 Për arsyet e shtjelluara në Urdhrin për Zhdëmtim, Trupi  
13 Gjykues gjykoi se kompensimi i secilës viktimë është njëlloj  
14 dhe modaliteti më i përshtatshëm i zhdëmtimit në këtë çështje  
15 gjyqësore.

16 Megjithëse, sikurse u shpreh edhe Mbrojtësja e Viktimave,  
17 asnjë shumë parash nuk do të mund të kthejë anëtarin e humbur  
18 të familjes dhe as të ndreqë vitet e depresionit, e një jete  
19 të privuar nga mundësia për të punuar si më parë dhe për të  
20 jetuar një jetë që ka dhe gëzime e lumturi, kompensimi do të  
21 mundësojë një farë lehtësime financiar për viktimat.

22 Tani do të trajtoj kuadrin e përgjegjësisë së z. Mustafa  
23 për zhdëmtimet. Do të filloj me kërkesat e Mbrojtëses së  
24 Viktimave.

25 Mbrojtësja e Viktimave në lidhje me Viktimën 08 kërkoi

1 më së paku 30,000 euro për dëm material, fizik dhe mendor.

2 Në lidhje me Viktimën 09, ajo kërkoi, më së paku 80,000  
3 euro për dëm material, fizik dhe mendor.

4 Në lidhje me Viktimën 10, ajo kërkoi, më së paku 60,000  
5 euro për dëm material, fizik dhe mendor.

6 Së fundi, ajo kërkoi, 10,000 euro për Viktimën 05,  
7 Viktimën 06 dhe Viktimën 12; 5000 euro për Viktimën 11; dhe,  
8 2000 për Viktimën 13, si kompensim për dëmin mendor.

9 Tani do të kaloj në vendimin e Trupit Gjykues lidhur me  
10 kuadrin e përgjegjësisë së z. Mustafa për zhdëmtimet.

11 Z. Mustafa, ka përgjegjësisë për dëmit që u shkaktua të  
12 gjitha Viktimave të Drejtpërdrejta dhe jo të Drejtpërdrejta të  
13 krimeve për të cilat u shpall fajtor. Kjo është pavarësisht  
14 nga format e ndryshme të përgjegjësisë penale mbi të cilat u  
15 mbështet shpallja e fajësisë dhe pavarësisht nëse edhe të  
16 tjerë mund të kenë kontribuar në shkaktimin e dëmit.

17 Së dyti, Trupi Gjykues duhet të përcaktojë nga një shumë  
18 për secilin lloj të dëmit dhe gjithashtu një shumë të  
19 gjithsejtë për përgjegjësinë financiare të z. Mustafa që e  
20 gjykon të arsyeshme, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

21 Për më tepër, kur përcaktoi shumën për përgjegjësinë  
22 financiare të z. Mustafa, Trupi Gjykues mori parasysh shkallën  
23 dhe përmasat e dëmit që pasuan viktimat si dhe kërkesën e  
24 Mbrojtëses së Viktimave për zhdëmtim. Gjithashtu mori parasysh  
25 legjislacionin përkatës në Kosovë. Ky legjislacion trajton të

1 drejtat dhe përfitimet që kategori të ndryshme personash të  
2 prekur nga konflikti i armatosur në Kosovë midis viteve 1998,  
3 1999 gëzojnë. Në këto kategori përfshihen, veteranët dhe  
4 civilët që pësuan dëm gjatë konfliktit të armatosur; ata që  
5 morën pjesë në luftë, dhe familjarët e anëtarëve të Ushtrisë  
6 Çlirimtare të Kosovës dhe të civilëve të vdekur ose të  
7 zhdukur. Trupi Gjykses vendosi të mbështetet në këtë  
8 legjislacion si pikë reference për përcaktimin e  
9 dëmshpërblimit që gjykon të arsyeshëm në kontekstin e Kosovës.

10 Po ashtu mori parasysh raportin Lerz. Trupi Gjykses vuri  
11 re se raporti në fjalë përmbante vlerësime të përafërta të  
12 humbjeve ekonomike të Viktimave të Drejtpërdrejta.

13 Po ashtu, Trupi Gjykses vlerësoi se këto shuma nuk ishin  
14 joproportionale në krahasim me kompensimet ekzistuese sipas  
15 legjislacionit të Kosovës sikurse u përmend më herët.

16 Sa i përket Viktimave jo të Drejtpërdrejta, Trupi Gjykses  
17 vlerësoi se shuma që kërkoi Mbrojtësja e Viktimave si  
18 kompensim për dëmin që pësuan viktimat ishin në përputhje me  
19 ato në lidhje me Viktimat e Drejtpërdrejta, megjithëse  
20 pasqyrojnë lloj të ndryshëm të dëmit mendor.

21 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se shumat që kërkoi  
22 Mbrojtësja e Viktimave pasqyronin shkallët dhe përmasat e  
23 dëmit që pësuan viktimat dhe ishin të arsyeshme sikurse  
24 parashikohet në nenin 22, paragrafi 3, i ligjit.

25 Mbi bazën e konstatimeve të mësipërme, duke mbajtur

1 parasysh shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan Viktimat e  
2 Drejtpërdrejta dhe jo të Drejtpërdrejta dhe në raste  
3 paqartësish duke vendosur në favor të personit të shpallur  
4 fajtor, Trupi Gjykses caktoi shumën e gjithsejtë të  
5 dëmshpërblimit për të cilin z. Mustafa mban përgjegjësi  
6 ligjore në vlerën 207.000€.

7 Rrjedhimisht, z. Mustafa urdhërohet t'u paguajë si  
8 kompensim për dëmin e shkaktuar:

9 30,000 euro Viktimës 08;  
10 80,000 euro Viktimës 09;  
11 60,000 euro Viktimës 10;  
12 Nga 10,000 euro Viktimës 05, Viktimës 06 dhe Viktimës 12;  
13 5000 euro Viktimës 11; dhe  
14 2000 euro Viktimës 13.

15 Këtu përfundon vendimi i Trupit Gjykses në lidhje me  
16 përgjegjësinë financiare të z. Mustafa për zhdëmtim.

17 Pjesa e fundit e Urdhrit për Zhdëmtim ka të bëjë me  
18 vënien në jetë dhe zbatimin e tij.

19 Trupi Gjykses theksoi se juridiksioni në këtë çështje  
20 gjyqsore do të përfundojë me nxjerrjen e këtij Urdhri për  
21 Zhdëmtim. Për këtë arsye, Trupi Gjykses ftoi kryetarin e  
22 Dhomave të Specializuara të Kosovës të caktojë një autoritet  
23 gjyqsor përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies  
24 në jetë dhe zbatimin e këtij urdhri për zhdëmtim.

25 Sa i përket zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi

1 Gjykues nënvijëzoi se përgjegjësinë për pagesën e kompensimit  
2 për viktimat të caktuara nga ky Trupi Gjykues e mban  
3 ekskluzivisht z. Mustafa.

4 Trupi Gjykues megjithatë theksoi, se në kohën e lëshimit  
5 të Urdhrit për Zhdëmtim, z. Mustafa nuk zotëron mjetet  
6 financiare për zbatimin e plotë të këtij urdhri. Trupi  
7 Gjykues, rrjedhimisht, konstatoi se z. Mustafa i mungojnë  
8 pjesërisht mjetet financiare për zhdëmtim. Sidoqoftë, Trupi  
9 Gjykues vendosi që si shtojcë të këtij urdhri për zhdëmtim të  
10 lëshoj një vendim për dhurimin e dorëzimit të të dhënave e  
11 dokumenteve në lidhje me z. Mustafa për të parë nëse pasuria  
12 aktuale e tij mund të përdoret për zbatimin e këtij urdhri  
13 ndonëse të pjesëshëm, pra, të Urdhrit për Zhdëmtim. Sidoqoftë,  
14 fakti se z. Mustafa i mungojnë pjesërisht mjetet financiare,  
15 nuk e liron atë nga detyrimi ndaj viktimave dhe ai mbetet  
16 përgjegjës për shumën e plotë të dëmshpërblimit të caktuar.  
17 Në lidhje me këtë, autoriteti gjyqësor që do të caktohet nga  
18 kryetarja e DHSK-së do të jetë përgjegjës për monitorimin në  
19 vazhdimësi të gjendjes financiare të z. Mustafa, me qëllim  
20 zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim.

21 Duke marrë parasysh gjendjen financiare të z. Mustafa,  
22 Trupi Gjykues theksoi nevojën për përfshirjen e aktorëve të  
23 tjerë për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim. Trupi Gjykues  
24 theksoi se një nga aktorët e parë të tillë mund të jetë  
25 Kosova.



1 Në parashtrimet e saj, Ministria e Drejtësisë e Kosovës  
2 informoi Trupi Gjykses se viktimat e krimeve të përfshira në  
3 juridiksionin e DHSK-së mund t'u akordohet kompensim ose  
4 dëmshpërblim nga programi për kompensimin e viktimave të  
5 krimit, i cili u themelua në bazë të ligjit për kompensimin e  
6 viktimave të krimit. Ky program kompensimi mund të aktivizohet  
7 kur është përcaktuar se personi i shpallur fajtor nuk është në  
8 gjendje të paguajë kompensimin qoftë pjesërisht apo  
9 plotësisht. Edhe pse ky ligj kohët e fundit u shfuqizua dhe  
10 është zëvendësuar me ligj të ri, parashtrimet e Ministrisë së  
11 Drejtësisë mbeten në fuqi dhe në kontekstin e ligjit të ri.

12 Për të ruajtur anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në  
13 proceset e DHSK-së dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre,  
14 Trupi Gjykses gjykoi se Administratorja, në koordinim me  
15 Mbrojtësen e Viktimave janë personat më të përshtatshëm për të  
16 kërkuar kompensim prej Programit për Kompensimin e Viktimave  
17 të krimit në emër të viktimave.

18 Sidoqoftë, Trupi Gjykses vuri në dukje nevojën  
19 parashikimin e mënyrave të tjera për zbatimin e plotë të  
20 Urdhrit për Zhdëmtim, duke mbajtur parasysh shumat maksimale  
21 që mund të akordohen nga Programi për Kompensimin e Viktimave  
22 të Krimit.

23 Tani do të flas për një mënyrë tjetër zbatimi;  
24 konkretisht, krijimin e një mekanizmi të ri për zhdëmtim në  
25 Kosovë.

1 Trupi Gjykses vuri re faktin që Kosova nuk ndërmoi asnjë  
2 hap nga ana e saj për t'u përgatitur konkretisht për nevojën  
3 për të mundësuar zhdëmtimin e viktimave të krimeve të  
4 përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të  
5 Kosovës. Trupi Gjykses gjithashtu theksoi se Kosova parashikoi  
6 nevojën për të mbështetur financiarisht Mbrojtjen e të  
7 dyshuarit dhe të akuzuarëve para DHSK-së. Gjithashtu vërejti  
8 se legjislacioni i Kosovës që trajton dëmin dhe lëndimet e  
9 pësuarra në kontekstin e luftës në Kosovë në vitet 1998, 1999,  
10 u referohet ekskluzivisht viktimave të forcave të armikut dhe  
11 jo të gjitha viktimave të luftës në Kosovë. Për mendimin e  
12 Trupi Gjykses, këto ligje krijuan diskriminim midis viktimave  
13 të kësaj lufte.

14 Trupi Gjykses bëri të ditur se nuk ka kompetenca për të  
15 urdhëruar Kosovën të paguajë dëmshpërblimin që i është  
16 akorduar viktimave.

17 Megjithatë, Trupi Gjykses vlerësoi se është e rëndësishme  
18 t'i kujtonte Kosovës detyrimet e saj në lidhje me të drejtat e  
19 viktimave për mjet juridik efektiv të mishëruar në nenin 54 të  
20 Kushtetutës dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo e drejtë  
21 përfshin gjithashtu edhe detyrën për të garantuar zbatimin e  
22 një mjete të tillë juridik.

23 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i bëri thirrje Kosovës të  
24 miratojë ligjet e nevojshme, të krijojë mekanizëm për zhdëmtim  
25 me qëllim kompensimin e plotë të viktimave të krimeve të

1 përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të  
2 Kosovës. Sipas Trupit Gjykses, kjo do të garantonte brenda  
3 sistemit ligjor të Kosovës, një trajtim të barabartë midis  
4 viktimave të dyshuarve ose të akuzuarve në proceset e DHSK-së.

5 Trupi Gjykses gjithashtu nënvijëzoi, se në krijimin e një  
6 mekanizmi të tillë për zhdëmtim, duhet shqyrtuar mundësia e  
7 financimit të tij përmes buxhetit të Kosovës, meqenëse dhe  
8 Mbrojtja e të dyshuarve dhe të akuzuarve para DHSK-së,  
9 financohet përmes atij buxheti. Trupi Gjykses vlerëson se një  
10 përdorim i tillë i barabartë i buxhetit të Kosovës do të  
11 promovonte mandatin e DHSK-së sipas nenit 1(2) të Ligjit, të  
12 mbështetur nga Kosova dhe shtetet anëtare të Bashkimit  
13 Evropian, së bashku me vendet e tjera kontribuuese me  
14 themelimin e DHSK-së dhe financimin e punës së saj.

15 Sidoqoftë, Trupi Gjykses theksoi se në qoftë se viktimat  
16 e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së nuk mund të  
17 realizojnë të drejtën e tyre për zhdëmtim, kjo e drejtë do të  
18 bëhet e pakuptimtë.

19 Për këtë arsye, Trupi Gjykses rekomandoi krijimin e një  
20 fondi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e  
21 DHSK-së, me nismën e DHSK-së, në rast se Kosova nuk i përmbush  
22 detyrimet që ka ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme  
23 përmes krijimit të një mekanizmi për zhdëmtim. Fondi duhet të  
24 mbështetet financiarisht, para së gjithash, nga Kosova, si dhe  
25 nga shtete donatorë të tjerë që dëshirojnë t'u ofrojnë

1 mbështetje viktimave.

2 Rrjedhimisht, për arsyet e përmendura më lart, Trupi  
3 Gjykues lëshon:

4 Urdhër për zhdëmtim kundër z. Mustafa;

5 Konstaton se Viktima 08, 09, 10, 05, 06, 12, 11 dhe 13  
6 provuan në bazë të standardin të vërtetimit tërësisë së  
7 gjasave se janë viktima të krimeve për të cilat z. Mustafa u  
8 shpall fajtor;

9 Vendos t'u akordojë dëmshpërblim Viktimave të  
10 Drejtpërdrejta dhe jo të Drejtpërdrejta;

11 Akordon zhdëmtim individual në formë të kompensimit;  
12 Cakton shumë të zhdëmtimit për të cilën z. Mustafa është  
13 përgjegjës vlerën 207.000 euro.

14 Urdhëron z. Mustafa të paguajë si kompensim për dëmin e  
15 shkaktuar:

16 30,000 euro Viktimës 08;

17 80,000 euro Viktimës 09;

18 60,000 euro Viktimës 10;

19 Nga 10.000 euro përkatësisht Viktimave 05, 06 dhe 12;

20 5000 euro viktimës 11; dhe

21 2000 euro Viktimës 13,

22 Kjo duhet të realizohet brenda afatit që do të  
23 përcaktohet nga autoriteti gjyqësor përgjegjës për monitorimin  
24 dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimin të Urdhrit për  
25 Zhdëmtim.

1 Trupi Gjykses konstaton se z. Mustafa i mungojnë  
2 pjesërisht mjetet financiare për zbatimin e këtij Urdhri për  
3 Zhdëmtim:

4 Lëshon vendim për urdhërimin e dorëzimit të të dhënave të  
5 dokumenteve me qëllim zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim dhe  
6 urdhra të tjerë në lidhje me të bashkëlidhur këtij urdhri për  
7 zhdëmtim;

8 Urdhëron Administratorin të marrë masat e nevojshme për  
9 vënien në jetë këtij Urdhri për zhdëmtim;

10 Fton Kryetarin e DHSK-së të caktojë autoritetin gjyqësor  
11 i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e  
12 vënies në jetë dhe zbatimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim;

13 Fton Kosovën të krijojë një mekanizëm të ri zhdëmtimi për  
14 viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin DHSK-së.

15 Urdhëron administratoren t'ia përcjellë këtë Urdhër për  
16 Zhdëmtim në versionin e redaktuar publik të tij qeverisë së  
17 Kosovës; dhe

18 Rekomandon krijimin e një fondi, me nismën e DHSK-së, për  
19 viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së në  
20 rast se Kosova nuk i përmbush detyrimet e saj ndaj viktimave  
21 brenda një kohe të arsyeshme përmes krijimit të një mekanizmi  
22 për zhdëmtim.

23 Këtu përfundon përmbledhja e Urdhrit për Zhdëmtim.

24 Zyra Administrative do të dorëzojë aktgjykimin në formë  
25 elektronike dhe z. Mustafa do të marrë një kopje të

1 certifikuar në ambientin e paraburgimit në gjuhën angleze.  
2 Përkthimin në shqipe do t'i dorëzohet z. Mustafa sapo që të  
3 përfundojë.

4 Këtu mbyllet procesi i parë në lidhje me këtë çështje.

5 Seanca mbyllet këtu.

6 --- Seanca mbyllet në orën 12.32

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25